

## Neni 20

### Emërimi i Kancelarit

1. Kancelari pranohet në punë nga Komisioni ad hoc i Institucionit të Komisionerëve Publikë, parashikuar në nenin 18, të ligjit për rivlerësimin dhe nëpërmjet një procedure të hapur dhe transparente.

Mbledhja e Komisionerëve Publikë shpall vendin vakant nëpërmjet publikimit në media. Kandidatët e interesuar për Kancelar, krahas kërkesës së motivimit me shkrim, duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

a) Ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për Drejtësi ose në Shkenca ekonomike, me diplomë “Master i shkencave”, në Shqipëri ose studimet universitare për Drejtësi ose në Shkenca ekonomike jashtë vendit dhe ka marrë një diplomë të njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuar me ligj.

b) Ka pasur një përvojë pune në nivel menaxherial dhe drejtues, jo më pak se 8 vjet.

c) Ndaj tij të mos ketë nisur një hetim penal, të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.

ç) Të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze.

d) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit.

dh) Nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike ose nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 8 viteve të fundit.

ë) Nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para vitit 1990, sipas ligjit “Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish-Shërbimit të Sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

Për vërtetimin e plotësisht të kriterëve të mësipërme, aplikanti dorëzon pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë të gjithë dokumentacionin që mendon të nevojshëm, në origjinal ose kopje të noterizuar.

2. Komiteti *ad hoc* vendos për zgjedhjen e kandidatit bazuar në dokumentet e paraqitura dhe një intervistë me gojë.